

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“Sarah Consulting” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 23/08/2023, Themeluesit:

1. **Z. Arton Vllasa**, lindur në Prishtine, Kosove me 03.04.1983, banues në Prishtine, me leternjoftim nr personal **1001247111**.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është

“Sarah Consulting” sh.p.k

Emri tregtar i shoqërisë : “Sarah Consulting” SHPK

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: TIRANE Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Emin Duraku" godina nr 6, hyrja 11, ap 12

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.



Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

1. Ne fushen e tregtise shoqeria do te kryeje: Konsulence dhe sherbime ne teknologji informatike, siguri kibernetike dhe tregtim me pakice te paisjeve informatike, teknologjike ,etj

Neni 5- Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njëqind mije) lekë.

Kapitali themeltar është i perberë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100000 (Njëqind mije) leke.

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njëqind mije) lekë.

Kapitali themeltar është i perberë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100000 (Njëqind mije) leke.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaket e shoqerise perkatesisht:

1. **Z.Arton Vllasa**, lindur në Prishtine, Kosove me 03.04.1983, banues në Prishtine, me leternjoftim nr personal **1001247111**, vlere e kapitalit te pergjithshem **100.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.



2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i vetëm i shoqërisë është : Z.Arton Vllasa**, lindur në Prishtinë, Kosove me 03.04.1983, banues në Prishtinë, me letërnjoftim nr personal **1001247111 me afat 5-vjecare.**
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Tirane , më 23/08/2023.

ORTAKET E SHOQERISE

Arton Vllasa

